REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr. 11045/2 Prot

Lushnje, më 23.12 2025

VENDIM
NR 122 DATË 23 12.2025

"MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026" SI DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028(PBA) TË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 23-12- 2025, pasi analizoi relacionin "M*bi miratimin e buxhetit vjetor 2026 si dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028(PBA) të Bashkisë Lushnje*", si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar*, neni 9 pika 1.3 gërma "c", neni 18 pika 1,neni 54 germa "dh" si dhe neni 41; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4, neni 5 gërma "a", neni 6 gërma "d", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 6 dhe 17, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.8 datë 28.2.2025 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor për vitet 2026-2028" si dhe në shkresën me nr 15867 prot datë 06.11.2025 e Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2026.

VENDOSI:

I.Të miratojë buxhetin e Bashkisë Lushnje për Vitin 2026:

- Të ardhurat 2,132,797,335 lekë
- Shpenzimet 2,132,797,335 lekë

I/1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Lushnje për vitin 2026 në shumën 2,132,797,335 lekë, si më poshtë:

Emërtimi	Plani 2026/ në lekë
I. Të ardhura lokale	925,579,000
1.Të ardhurat e viti 2026	640,579,000
a)Të ardhura të taksueshme	371,620,000
b)Të ardhura të jo tatimore	175,019,000
c)Të ardhura të tjera	93,940,000

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia.lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

2. Të ardhura të trashëguara nga viti.2025	285,000,000
II. Transferta e pakushtëzuar v. 2026	622,969,864
III. Transferta e pakushtezuar sektoriale v. 2026	584,248,471
TOTALI (I+II+III)	2,132,797,335

I/2. Të miratojë planin e shpenzimeve të Bashkisë Lushnje për vitin 2026 në vlerën 2,132,797,335 lekë, sipas klasifikimit ekonomik si më poshtë.

Nr.	Plani i shpenzimeve	Shpenzime 2026 /ë lekë
1	Shpenzime për paga	973,420,780
2	Shpenzime për sigurime shoqërore shëndetesore	167,251,956
3	Shpenzimet Operative	559,143,937
4	Investime	432,974,662
	TOTALI	2,132,797,335

Shpenzimet sipas programeve dhe njësive shpenzuese janë sipas tabelave bashkalidhur.

II. Të miratojë numrin e punonjësve buxhetore gjithsej 1100 punonjës sipas tabelës bashkalidhur dhe structures,si dhe 2 punonjës për projektin Rural Coop miratuar me VKB nr 57 datë 30.06.2025

III Fondi prej 40,000,000 lekë do të përdoret në subvencionimin e "K.F Lushnja 1930" sh.a.

IV.Të miratojë listen e projekteve të investimeve sipas tabelës bashkëlidhur.

V. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm përfundimtar:

- Për vitin 2027 në vlerën 2,106,177,469 lekë
- Për vitin 2028 në vlerën 2,127,113,743 lekë

(Tabelat Bashkëlidhur)

VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Të gjitha drejtoritë e bashkisë si dhe ndërmarrjet vartëse.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA LUSHNJE

08

11045
15.12.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Lushnjë, më 15/12/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026 SI DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 (PBA) TË BASHKISË LUSHNJE"

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Buxheti është një instrument financiar i cili ndërtohet në bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve të institucionit të Bashkisë, të ndara sipas llojit dhe qëllimit të shfrytëzimit për vitin buxhetor. Detajimi i buxhetit bëhet bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 9396 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe ligjit të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 181/2013. Për hartimin e tij ashtu si dhe e parashikon ligji 146/2014 kemi zhvilluar disa dëgjesa me qytetarët për të përcaktuar prioritetet për çdo Njësi Administrative dhe grupet e interesit.

Kapitulli I: Informacion i përgjithshëm mbi buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2026.

Hartimi i Buxhetit për vitin 2026 vazhdon në rrugën e nisur dhe të konsoliduar tashmë nga administrata aktuale që prej disa vitesh me një përfshirje të të gjitha institucioneve të vartësisë së Bashkisë së Lushnjës në këtë proces bashkë me të 10 (dhjetë) njësitë administrative që u përfshinë nga zbatimi i reformës territoriale. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur të gjitha hapat e përcaktuara në ligj.
Buxheti i vitit 2026 është hartuar duke u mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",të ndryshuar, Ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.23 datë 30.07.2018 "Për

procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" si dhe në shkresën nr 15687 prot datë 06.11.2025 e Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2026.
Ky buxhet është planifikuar në bazë të burimeve të mundshme dhe të realizueshme të të ardhurave nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e gjeneruara lokale, si dhe nga kalimi i disa funksioneve me transfertën sektoriale të pakushtëzuar. Kjo mundëson realizimin e shpenzimeve në kohë sipas një programi të parashikuar të gjenerimit të të ardhurave dhe mundesisë për likuiditete në çdo kohë të lindjes së shpenzimit.

Buxheti i vitit 2026 është hartuar duke kryer shpërndarjen më të mirë të burimeve të të ardhurave me një tendencë në rritje drejt mirëmbajtjes së shërbimeve, duke balancuar së pari nevojën afat-shkurtër të komunitetit me strategjitë afatmesme dhe vizionin afatgjatë për zhvillimin e Bashkisë Lushnjë. Ai siguron që burimet e të ardhurave të shpërndahen në mënyrë të drejtë ndaj të gjithë zonave të territorit të Bashkisë Lushnjë, duke barazuar shpërndarjen pavarësisht kontributit të të ardhurave që komunitetet kanë sipas zonave. Kjo rishpërndarje ka bërë që zonat e periferisë të përfitojnë shërbime në nivele të krahasueshme me nivelet kontribuese në buxhetin e Bashkisë.

Burimet kryesore të të ardhurave të buxhetit të Bashkisë janë:

- Të ardhurat lokale, që në vetvete përmbajnë taksa, tarifa dhe të ardhura të tjera dytësore;
- Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar;
- Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar sektoriale.

Ndarja e Transfertës së pakushtëzuar ose granti nga buxheti i shtetit, që u jepet njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre bëhet në përputhje me nenin 24,të Ligjit nr.68,dt.27.04.2017.

Pjesë e Buxhetit është edhe transferta e pa kushtëzuar specifike që nga fund vitit 2018 është quajtur edhe transfertë sektoriale e pakushtëzuar.

1.Transfertat e pakushtëzuara sektoriale financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për:
a) financimin e funksioneve të transferuara të njësivë të vetëqeverisjes vendore;
b) financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë për të vendosur për shpenzimet brenda funksionit, sipas transfertës specifike të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të mësipërme.
3. Transferta specifike vjetore, sipas shkronjës "a", të pikës 1, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore është, të paktën, sa mesatarja vjetore e shpenzimeve totale që qeverisja qendrore ka kryer për të njëjtin funksion në tre vitet e fundit para transferimit të funksionit në secilën nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura.

Ky Buxhet përmban dhe përshkruan:

- Se si do të reflektohen në buxhetin e vitit 2026 politikat fiskale të aplikuara.
- Si do të ndikojnë këto politika në përmbushjen e objektivave të Bashkisë së Lushnjës.
- Si janë vendosur prioritetet për vitin 2026 për investimet kapitale.
- Si do të realizohen shpenzimet për përmbushjen e funksioneve.

Të gjitha institucionet dhe Ndërmarrjet e vartëse, emërtuar sipas ligjit "Njësi Shpenzuese", kanë përcaktuar aktivitetet që do të kryhen për arritjen e objektivave, produktet dhe kostot e tyre.

Buxheti i vitit 2026 garanton objektivat e tij për:

- Një përmirësim të paketës fiskale në drejtim të përmirësimit të detyrimeve fiskale;
- Dhenia e ndihmës për familjet në nevojë dhe të pastreha si pjesë e 6% në vazhdim të fondit të kushtëzuar;
- Një nivel të ndryshuar të shpenzimeve administrative;
- Një nivel më të lartë të mirëmbajtjes në infrastrukturën publike, arsim, shërbime publike, etj;
- Vazhdimin e përfundimin e projekteve të nisura nga vitet e mëparshme;
- Investime të reja në infrastrukturën publike;
- Funksionet, shpenzimet e të cilave janë transferuar nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale si: Arsimi parashkollor, QKF, shërbimi mbështetës në arsimin 9-vjecar dhe të mesëm, funksioni ujitjes dhe kullimit, funksioni i shërbimit zjarrfikës, administrimi i rrugëve rurale dhe shërbimi pyjor.
- Dhënien e stimulit financiar për nxënësit me rezultate të larta në mësime; etj.

Programi buxhetor financiar për vitin 2026 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve në vite, si edhe në vendimmarrjen për rritjen e standardeve apo cilësisë së tyre. Këto analiza janë shoqëruar edhe me zbatimin e metodave të reja të buxhetimit, të cilat garantojnë zbatimin e politikave në rritjen e eficensës dhe efektivitetit të burimeve financiare, në përputhshmëri me ndikimin e programeve të ndryshme në zhvillimin ekonomik të qytetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin.

Teknikat e përdorura për hartimin e buxhetit janë:

- Përgatitja e buxhetit bazuar në program dhe produkt.
- Përgatitja e buxhetit të balancuar. Kjo formë detyron formulim të qartë të prioriteteve në çdo nivel organizativ.

Njësitë Pjesëmarrëse në Buxhetin 2026 janë:

Aparati i Administratës së Bashkisë Lushnjë, i cili përmban drejtoritë sipas strukturës, pesë njësitë administrative të qytetit, dhjetë njësitë administrative që ju bashkuan qytetit nga reforma teritoriale, Shërbimin e Policisë Bashkiake, Mbrojtjen nga Zjarri dhe Mbrojtjen Civile, Menaxhimin e Pyjeve dhe Kullotave, Investime në Rrjetin Rrugor, Kujdes Social për të Moshuarit dhe Të Pastrehët etj.

Ndërmarrjet dhe Institucionet e Varësisë, të cilat përbëhen nga:

1. Ndërmarrja e Pasurisë Publike e cila përmban administratën sipas strukturës, Menaxhimin e Ujitjes dhe Kullimit, Mirëmbajtje në rrjetin rrugor urban dhe rural, Shërbime Publike Vendore, përfshirë dhe varrezat, ndriçim rrugësh, mbrojtja e mjedisit, gjelbërimi etj.

2. Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit, e cila përmban kulturën dhe artin, siç janë Kinoteatri, Biblioteka dhe Muzeu si dhe Sportin dhe argëtimin, ku bëjnë pjesë klubet e sporteve të ndryshme me aktivitetet sportive. Nga ky institucion merr subvencionin dhe Klubi i Futbollit.

3. Qendra e Arsimit, e cila mbulon arsimin bazë dhe parashkollor, përfshirë dhe çerdhet, arsimin e mesëm të përgjithshëm, arsimin profesional, Qendrën e Kujdesit Social PAK, si dhe mirembajtjen e institucioneve shtetërore në pronësi/administrim të Bashkisë Lushnje.

Të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet e varësisë emërtuar sipas ligjit "Njësi Shpenzuese" kanë përcaktuar aktivitetet që do të kryhen për arritjen e objektivave, produktet dhe kostot e tyre. Parashikimi i shpenzimeve bëhet për çdo kategori shpenzimesh sipas funksioneve dhe shpenzimi për çdo program bëhet në bazë të parashikimit të personelit, shpenzimeve operative, si dhe shpenzimeve kapitale. Parashikimi i të ardhurave bëhet duke iu referuar çdo takse dhe tarife të përcaktuar në paketën fiskale, të cilat analizohen në hollësi.

Buxheti i Bashkisë Lushnje për vitin 2026 është një buxhet i balancuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, i programuar në vlerën 2,132,797,335 lekë.

Kapitulli II: Parashikimi i të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2026

Për vitin 2026 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Lushnje parashikohen në shumën **2,132,797,335 lekë.** Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat, nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	**Plani 2026/ në lekë**
I. Të ardhura lokale	925,579,000
1.Të ardhurat e vitit 2026	640,579,000
a)Të ardhura të taksueshme	371,620,000
b)Të ardhura të jo tatimore	175,019,000
c)Të ardhura të tjera.	93,940,000
2. Të ardhura të trashëguara nga viti 2025	285,000,000
II. Transferta e pakushtëzuar v. 2026	622,969,864
III. Transferta e pakushtëzuar sektoriale v. 2026	584,248,471
TOTALI (I+II+III)	2,132,797,335

II. 1 Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore për vitin 2026 janë programuar në shumën 640,579,000 lekë.

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore grupohen në:

Të ardhura të taksueshme.
Për vitin 2026 këto të ardhura arrijnë në shumën 371,620,000 lekë të cilat do të mbulojnë shpenzimet bazë dhe do të bëjnë të mundur funksionimin e shërbimeve kryesore të Institucionit të Bashkisë.
Të ardhura jo tatimore.
Të ardhurat jo tatimore për vitin 2026 parashikohen në rreth 175,019,000 lekë.
Të ardhura të tjera:
Të ardhurat të tjera për vitin 2026 parashikohen në rreth 93,940,000 lekë.

Të ardhurat e vitit

Emertimi	Plan 2026
Te ardhura tatimore/lekë	371,620,000
Te ardhura jo tatimore/lekë	175,019,000
Te ardhura te tjera	93,940,000
TOTALI	**640,579,000**

Mbështetur në praktikat shumëvjeçare dhe në metodologjinë e zbatuar të deri tanishme, parashikimi i treguesëve mbi të ardhurat për periudhat e mëvonshme, ka si bazë realizimin aktual të tyre si dhe politikat dhe strategjitë e projektuara për të ardhmen.
Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 mbështetet kryesisht në të dhënat si më poshtë

- Realizimin faktik të të ardhurave në vitin 2025;
- Numrin e subjekteve aktivë të evidentuar nga struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Lushnje;
- Parashikimin e të ardhurave nga subjekte debitore në vite dhe kryesisht ato të vitit 2022-2025;
- Parashikimin e të ardhurave nga subjektet që mund të Rregjistrohen të reja gjatë vitit 2026.
- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimorë.
- Parashikimi i të ardhurave nga lejet e zhvillimit dhe përdorimit.
- Parashikimi i të ardhurave nga shërbimet që realizohen nga Bashkia Lushnje dhe Ndërmarrjet e Varësisë.

II.2. Të ardhura nga Buxheti i Shtetit (Transferta e Pakushtëzuar)

Çdo vit Buxheti i Shtetit me miratimin e ligjit për buxhetin përcakton dhe shumën e transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar.
Transferta e pakushtëzuar (granti) është e ardhur e përfituar në formë dhurimi, për një qëllim të përcaktuar ose jo, pa kusht kthimi dhe pa interes, që përdoret për financimin e veprimtarive ekonomike. Kjo transfertë akordohet nga pushteti qendror.

Për vitin 2026 transferta e përgjithshme e pakushtëzuar për Bashkinë e Lushnjes paraqitet në shumën 622,969,864 lekë, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara në shumën 584,248,471 lekë.

Kapitulli III: Parashikimi i shpenzimeve në Buxhetin e Bashkisë Lushnje për vitin 2026.

Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Bashkisë Lushnje për vitin 2026 parashikohet në vlerën e të ardhurave të barabarta me 2,132,797,335 lekë.

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve të programuara për vitin 2026 përcaktojnë:

- Rritjen me përparësi të shpenzimeve në sektorët prioritarë si menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit, mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, shërbimet e policisë vendore, shërbimet publike, shërbim social, etj;
- Procedura të buxhetimit të fokusuara te produkti/rezultati, për çdo program në veçanti;
- Ruajtjen të pandryshueshme të nivelit të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre;
- Rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes në shërbimet publike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë tendencës së rritjes së investimeve në vite;
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
  - Të vlerësimit të zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit,
  - Sigurimin e shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.

Shpenzimet e përgjithshme sipas natyrës ekonomike në buxhetin e vitit 2026 në lekë, paraqiten si me poshtë:

ARTIKULLI	PLANI 2026
I.Shpenzime personeli	**1,140,678,735.5**
II.Shpenzime operative	**559,143,937.5**
III.Investime	**432,974,662**
TOTALI (I+II+III)	**2,132,797,335**

-Në vlerën Subvencionim (shpenzimet operative) për 2026 që është në shumën 42,000,000 lekë përfshihen: 2,000,000 lekë subvencionim transporti urban për invalidët dhe veteranët dhe 40,000,000 lekë është subvencionimi për (sportin) "K. F Lushnja 1930".

III.1. Shpenzime Personeli (art.600+601)

Shpenzimet për personelin janë parashikuar në masën **1,140,678,735** lekë.
Konkretisht:
1. Fondi i pagave i planifikuar për vitin 2026 do të jetë 890,399,325 lekë.
2. Për vitin 2026 shpenzimet e planifikuara për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jenë 250,279,410 lekë.

Në shpenzimet e personelit numri i punonjësve është 1102. (1100 punonjës sipas strukturës dhe 2 punonjës për projektin Rural Coop)
Informacioni i detajuar për lëvizjet (shtesa, pakësime në numrin e punonjësve në materjalin e strukturës)
Numri i punonjësve dhe fondi i pagave sipas njësive shpenzuese është:

Nr	Emërtimi	Nr.ardhurat	Nr.tr.specif	Nr. Gjithsej	Shpenzime personeli
1	Bashkia	297	20	317	410,727,640
2	Ndërmarrja e Pasurisë Publike	262	38	300	250,148,003
3	Qendra Kulturës & Klubi Sportit	64	0	64	71,976,384
4	Qendra e Arsimit	176	245	421	407,826,708
	T O T A L I	**790**	**312**	**1,102**	**1,140,678,735**

Sic vihet re dhe nga tabela, një përqindje të konsiderueshme të fondit të pagave zënë dhe pagat e punonjësve të transfertave specifike që sic dihet shumë funksione qe iu deleguan pushtetit vendor në 2018, nuk u shoqëruan me kostot operative, por vetëm me fondin e shpenzimeve për paga dhe sigurime.
Gati 44 % të shpenzimeve të personelit janë nga funksionet e deleguara (transferta specifike)

III.2. Shpenzime Operative dhe të Mirëmbajtjes. (art.602-606)
Për vitin 2026, në total shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë projektuar në shumën 559,143,937 lekë. Theksojmë që, brenda këtyre shpenzimeve dhe pse janë me artikull 602 plotësohen një numër i lartë i nevojave për ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore, dhe jo vetëm pastrimi, gjelbërimi dhe ndriçimi. Shpenzimet operative mbulojnë gjithë shpenzimet që kryejnë njësitë shpenzuese përveç shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve kapitale.

Nga këto shpenzime, 52,317,990 lekë janë planifikuar për funksionin e mjedisit që mbulon shërbimin e pastrimit në qytet dhe në njësitë administrative.
Shpenzimet në sistemin e shërbimeve të pastrimit dhe gjelberimit janë planifikuar duke pasur parasysh:
-Koston reale për njësi të këtij shërbimi, duke përfshirë në të gjithë elementet e pastrimit, si atë të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe atyre inerte, jo vetëm në rrugë, por edhe në ambientet e tregtimit, si dhe dërgimin e tyre në incenerator.
-Zgjerimin e sipërfaqes së pastrimit edhe në zonat periferike dhe informale të qytetit.
-Analizën mbi gjendjen ekzistuese të sipërfaqeve të gjelbërta, të ndriçimit të rrugeve si dhe nevojat e ndërhyrjes në mirëmbajtjen e tyre, mbështetur në koston për njësi të ndërhyrjes, si dhe vlerën përkatëse.
Prej më shumë se dy vite, Bashkia Lushnje ka ndjekur një metodë për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes por dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore.
Shumë rrugë ndërtohen nga brigadat e Ndërmarrjes së Pasurisë Publike. Realizohet blerja e materialeve dhe punimet kryhen nga punonjësit e Ndermarrjes.
Disa nga këto shpenzime janë:

Blerje material cakëll për mirëmbajtjen e rrugëve në njësitë administrative në teritorin e Bashkisë Lushnje në vlerën 25,000,000 lekë.
Blerje materjale asfaltobeton për rruget në njësitë administrative në teritorin e Bashkisë Lushnje në vlerën 79,800,000 lekë.
Blerje material beton, hekur në vlerën 20,000,000 lekë për nderhyrjet në rruget në teritorin e Bashkisë Lushnje njesitë administrative.
Dihet tashmë që Bashkia realizon një pjesë të konsiderueshme të investimeve me ndërmarrjet e veta. Fondet e shënuara më lart përdoren pikërisht për këtë proces dhe më të detajuara do t'ju pasqyrohen në një relacion sqarues më vete. Materialet janë përgatitur nga drejtoritë përkatëse të ngarkuara për këtë proces.
Vlera prej 40,000,000 lekë i shkon për subvencion Klubit të Futbollit.
Vlera prej 6,000,000 lekë shkon për shpronësimet;
4,000,000 lekë shkojnë për detyrimet gjyqësore që kanë lindur nga marrëdhenie kontraktuale, marrëdheniet e punës apo shpronësime, por dhe të tjera nga ish komunat;
24,000,000 lekë janë për Mbrojtje dhe Emergjenca Civile;
13,000,000 lekë janë për fondin rezervë dhe të kontigjencë;
1,529,117 lekë janë për kuotë anëtarësie në Shoqatën për Autonomi Vendore;
2,000,000 lekë janë për Kontributin e Qarkut;
12,792,000 lekë janë për pagesat e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe 9,844,800 lekë të kryetarëve të fshatrave;
2,000,000 lekë është subvencion transporti urban,
Për qiratë e të pastreheve janë 5,700,000 lekë;
Energjia elektrike është planifikuar në masën 44,921,624 lekë (duke përfshirë këtu tre ndërmarjet);
Mbështetje projekte Kulture e Sport në masën 11,464,000 lekë;
6,600,000 lekë janë komisione për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të PAK-ut;
5,000,000 lekë si ndihmë ekonomike për familjet në nevojë që nuk plotësojnë 100% kushtet për përfitim nga sistemi i pikëzimit,
20,360,000 lekë janë për ushqimet në kopështe, çerdhe,
32,794,496 lekë shkojnë për kontratat në vazhim në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, por dhe të vitit 2025 që nuk mundën të likuidohen brenda vitit dhe pjesa tjetër është e planifikuar për blerje e shpenzime të paparashikuara në zërat e mësipërm.

Të ndara sipas programeve janë si më poshtë:

	Emërtimi i Programit		602 Korente të Tjera
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA129	101,786,443
2	Shërbimet Publike Komunitare	AB129	306,754,776
3	Arsimi	AC129	50,960,000
4	Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe Social	AD129	18,382,718
5	Art, Kulturë, Sport & Turizëm	AE129	68,260,000
6	Rezerva dhe Kontigjenca	AF129	13,000,000
	Totali		**559,143,937**

Shpenzimet operative sipas njësive shpenzuese janë:

Nr	Njesitë shpenzuese	Shpenzimet Operative
1	Bashkia	131,174,665
2	Nd/ja Pasurise Publike	308,049,272
3	Qendra Kultur&Kl. Sportit	51,660,000
4	Qëndra e Arsimit	68,260,000
	Shuma	**559,143,937**

1.Shpenzimet operative në rrjetin rrugor janë në vlerën 164,731,434 lekë

Ky planifikim ka në themel analizën mbi sistemin rrugor, duke mundësuar krijimin e një baze të dhënash mbi gjendjen ekzistuese të tyre, duke përfshirë edhe sinjalistiken e tyre, përcaktimin e volumeve të dëmtimeve të rrugëve, si dhe nevojat e ndërhyrjes në mirëmbajtjen e tyre, mbështetur në koston për njësi të ndërhyrjes. Është parashikuar që shumica e ndërhyrjeve në rrugë të realizohet nga Ndërmarja e Pasurise Publike me punonjësit e vetë. Kostoja e realizimit të këtyre shpenzimeve është më e ulet sesa kostoja po të realizoheshin me të tretë.

Disa nga shpenzimet kryesore (jo të gjitha) janë:

- Shpronësime në vlerën 6,000,000 lekë
- Blerje material cakëll për mirëmbajtjen e rrugëve në njësitë administrative në teritorin e Bashkisë Lushnje dhe vlerën 25,000,000 lekë.
- Blerje materjale asfaltobeton për rruget në njësitë administrative në teritorin e Bashkisë Lushnje në vlerën 79,800,000 lekë.
- Blerje materjal beton, hekur në vlerën 20,000,000 lekë për nderhyrjet në rruget në teritorin e Bashkisë Lushnje njesitë administrative.

2.Shpenzime operative për "Shërbime Bujqësore, Inspektime, Siguria Ushqimore & Mbrojtja Konsumatorëve" janë në vlerën 7,794,496 lekë.

Bashkia synon forcimin e rolit ekonomik të saj në rajon, si qendra e zhvillimit bujqësor. Zhvillimi i këtij sektori do të bëhet përmes promovimit të teknikave të prodhimit të produkteve organike dhe cilësore, etiketimit dhe marketimit të tyre, duke synuar rritjen e prezencës së tyre në tregjet vendase dhe ato të huaja. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore e blegtorale do të bëhet në mënyrë të qëndrueshme, duke u kujdesur për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe burimet e tjera natyrore me qëllim garantimin e mirëqënies sociale të qytetarëve ekzistues dhe brezave të ardhshëm. Profili ekonomik i bashkisë do të plotësohet me promovimin e ekoturizmit si potencial i pashfrytëzuar në territoret me peisazhe të Bashkisë së Lushnjës. Vëmendje i është kushtuar rrugëve kryesore, sidomos në njësitë administrative dhe në lagje të qytetit. Gjithashtu në vite është parashikuar si pjesë e buxhetit, ashtu si çdo vit, edhe mirëmbajtja e rrugëve bujqësore.

3.Transporti Publik, i cili ka të bëjë me subvencionimin e transportit urban me 2,000,000 lekë për Invalidët dhe Veteranët.

4.Kultura dhe sporti në vlerën 68,260,000 lekë.

Pjesën kryesore të fondeve në këtë program e zë subvencioni për Klubin e Futbolli

- Subvencion Klubi Futbollit në vlerën 40,000,000 lekë.

5.Arsimi bazë dhe parashkollor - çerdhe, i mesëm dhe profesional në vlerën 50,960,000 lekë
Në planifikimin e shpenzimeve për sistemin parashkollor + çerdhet janë parashikuar shpenzimet për mirembajtjen e objekteve arsimore, nevojat e ndërhyrjes për mirëmbajtjen e tyre, sigurimin me bazë materiale e didaktike për shkollat, sigurimin e ushqimit për fëmijët e kopshteve e çerdheve, sigurimin e ngrohjes, si dhe aktivitete kulturore argëtuese për fëmijët.
Gjithashtu vazhdojnë të programohen edhe stimuj financiarë për fëmijët që kanë rezultate të shkëlqyera në mësime apo janë fitues të Olimpiadave për të cilët është prekur fondi rezervë gjatë vitit.

- Qira për objekte për kopështe, në vlerën 1,000,000 lekë;
- Energjia elektrike + uji, në vlerën 12,450,000 lekë;
- Ushqimi në kopshte e çerdhe, në vlerën 20,360,000 lekë;
- Materiale për ndërtim, hidraulike, elektrike, riparime, në vlerën 8,500,000 lekë;
- Shpenzim për ngrohje 1,950,000 lekë;
- Transport nxënësish 2,000,000 etj

6.Sistemi shërbimeve dhe kujdesjes sociale në vlerën 10,532,000 lekë
Për vitin 2026 Bashkia Lushnje do të vazhdojë të ofrojë shërbime në kuadër të përkujdesjes sociale të grupeve në nevojë, duke zhvilluar mekanizma efikase, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit.
Bashkia do të vijojë të mbështesë Projektet Sociale me karakter ndërgjegjësues dhe sensibilizues për të gjitha aktivitetet në kuadër të ditëve kombëtare dhe ndërkombëtare të solidarizimit, fushata sensibilizuese për problematikat sociale, fushata informuese për shërbimet sociale që ofron Bashkia etj.
Ndjekja e politikes për pagësen e qirasë për familjet e pastreha në nevojë.

8.Planfikimi dhe administrimi në vlerën 66,875,161 lekë dhe Mbrojtje & Emergjenca Civile në vlerën 24,000,000 lekë.

- Këshilli Bashkiak dhe kryetarët e fshatrave në vlerën 22,636,800 lekë
- Vendime gjyqësore për detyrimet që kanë lindur nga marrëdheniet kontraktuale, marrëdheniet e punës apo shpronësime, në vlerën 4,000,000 lekë
- Blerje karburanti 5,834,400 lekë.
- Kuota e anëtarësisë në Shoqatën për Autonominë Vendore 1,529,117 lekë.
- Fondi emergjences civile 24,000,000 lekë.
- Energjia elektrike 3,671,624 lekë.
- Trajtimi i shtresave në nevojë me mbështetje ndihme ekonomike 5,000,000 lekë
- Shpenzime për komisione paaftesie e ndihmë ekonomike në masën 6,600,000 lekë, etj.

III.3. Shpenzime subvencioni (art.603) në vlerën 42,000,000 lekë
Në këtë grup shpenzimesh futet subvencioni që i jepet:

Transportit Urban për udhetimin pa pagesë të veteranëve të luftës dhe invalideve kjo në bazë të ligjeve përkatëse.
Për vitin 2026 subvencionimi i Transportit urban për qytetin do të jetë në vlerën 2.000.000 lekë.

-Sh.a "Klubit të Futbollit Lushnje 1930" në vlerën 40,000,000 lekë në të cilën përfshihen pagesat e futbollistëve dhe trajnerëve, premiot, pagesat e administratës si dhe shpenzimet operative.

III.4. Fondi Rezervë dhe i kontigjencës (art.604) në vlerën 13,000,000 lekë
Fondi rezervë është fondi që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të pa parashikuara në fazën e përgatitjes së buxhetit. Në buxhetin e vitit 2026 ky fond është parashikuar në shumën 8,000,000 lekë.
Fondi kontigjencës është fond i pa shpërndarë që krijohet për të mbuluar rrisqet e mundshme, për mosrealizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, gjatë zbatimit të buxhetit. Për vitin 2026 ky fond është parashikuar në shumën 5,000,000 lekë.

III.5. Kontributi për Qarkun
Në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 38 dhe të udhëzimit të MFE nr.9 datë 20.3.2018, kap.II/131.njësitë e qeverisjes vendore derdhin një kuotë për llogari të Këshillit të Qarkut. Për vitin 2026 këtë kuotë e kemi planifikuar në vlerën 2,000,000 lekë.

III.6. Shpenzimet Kapitale (art.231)
Planifikimi për vitin 2026 është mbështetur duke marrë në konsideratë kërkesat e komunitetit dhe të njësive shpenzuese, mbështetur në objektivat e Bashkise për zhvillimin e investimeve të domosdoshme në Bashkinë Lushnje duke mbajtur në vëmendje:

- Analizën e performancës së kryerjes së investimit,
- Shkallën e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social,
- Përputhshmërinë me zhvillimet rajonale,
- Numrin e përfituesëve nga zbatimi i investimeve,
- Shkallën e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe rritjes së aksesit në kryerjen e shërbimeve ndaj komunitetit,
- Prioritetet e përcaktuara në takimet me komunitetin, duke krijuar mundësinë e vendimmarrjes së qytetarëve në buxhet,
- Investime më shumë në sektorët prioritarë dhe të domosdoshëm për qytetin,
- Kostot për njësi të përcaktuara për investim,

Vlera totale e investimeve për vitin 2026 është 432,974,662 lekë. Për këtë vit Bashkia Lushnje ka në vëmendje të saj financimin e investimeve për objekte të reja, të cilat do i shtrijë në dy vite, si dhe për ato pak objekte të cilat janë në vazhdim nga viti 2025.
Shpenzimet kapitale (art. 231) kapin shifrën 432,974,662 lekë. Nisur nga prioritetet si dhe nga nevojat e paraqitura pjesa më e madhe e investimeve është adresuar në njësitë administrative, për t'u ardhur në ndihmë banorëve të këtyre zonave, me qëllim lehtësimin e jetesës së tyre, lehtësimin e lëvizjeve për në qytet si dhe midis vetë njësive. Këto janë projekte me një shtrirje gati 1-2 deri në 3 vjeçare (2026-2027-2028).

Pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë të parashikuara që në buxhetin e vitit 2026 dhe kanë një shtrirje deri në vitin 2027, po që gradualisht, sipas mundësive dhe nevojave do të plotësohen me investime të tjera gjatë viteve në vazhdim.

Mbështetur në ligjin organik të buxhetit, ligjin vjetor të buxhetit të shtetit për vitin 2026, Bashkia Lushnje planifikon investimet kapitale projektet si më poshtë:

Funks	Kap.	Kodi instituc	Emertimi investimeve sipas objekteve	Kodi projektit	Vlera plote projektit	Vlera mbetur	Parashimi 2026	Vlera e mbetur per 2026	2027	2028
01110	05	2129001	Blerje Pajisje & Invest.tjera Bashkia	P111AAB			2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000
01110	05	2129001	Rikonstruksion I brendshe I godines se bashkise 3-kateshe	P111AAD	82,653,151	-	33,061,261	33,061,261	36,596,568	12,995,323
06260	05 TR	2129001	Invest.Superviz.projektime,kolaudime inv.tj. te reja &nga vitet 26-28 (05)	P626AAS		6,482,400	-	6,482,400	73,486,990	97,772,479
06260	01 TR	2129001	Urbanizimi bllokut te banimit ne dushk sektor +mbikqyrja (Vazhdim)	P626AAM	31,991,970	2,113,145	-	2,113,145		
06260	01 TR	2129001	Urbanizimi bllokut te banimit ne lagjen Saver	P626AAP	30,000,000	3,000,000	-	3,000,000		
06260	01 TR	2129001	Rruge + rikompozim lulishte	P626AAR		1,888,680	-	1,888,680		
06260	01 TR	2129001	Invest.Superviz.projektime,kolaudime inv.tj. te reja &nga vitet 25-27 01	P626AAL		8,228,290	-	8,228,290	10,000,000	120,527,513
07220	05 TR	2129001	Rikonstruksion I Qendres Shendetsore Bubullime.	P722AAA	25,405,480	-	2,690,870	2,690,870		
08130	05 TR	2129001	Rikonstruksioni i Kompleksit Sportiv "Roza Haxhiu Lushnje	P813 AAE	7,000,000	1,046,859		1,046,859	19,008,954	
08140	05 TR	2129001	Rehabilitim I Palestres Shkolla "Foto Puka"	P813AAF		1,358,930	-	1,358,930	-	
09120	01 TR	2129001	Rindertim i Shkoles 9-vjecare "Hysen Xheka" - Karbunare	P912 AAD	53,297,198	-	2,797,198	2,797,198		
09120	01 TR	2129001	Rindertim i shkoles 9-vjecare "Irakli Bozo" - Golem	P912AAE	30,536,684	10,000,000		10,000,000		
09120	01 TR	2129001	Rikontruksion I godinës dhe palestrës 'Jani Nushu "	P912 AAI	73,460,941	11,032,744	-	11,032,744		
04520	01	2129001	Rikonstruksion i rruges "Azem Quka"	P452ACR	25,858,350	-	20,559,801	20,559,801		
04520	05	2129001	Ndertim i segmentir rrugor per kembesore , pergjate perroi, paralel me rrugen pas Komisiariatit	P452ACX	18,693,000			-	9,346,500	9,346,500
04520	01	2129001	Sistemimi i sheshit dhe tregut te fruta perimeve ne lagjen "Skender Libohova", rruga Pavarsia	P452ACU	13,290,089	10,000,000	3,290,089	13,290,089		
04520	01	2129001	Sistemim i sheshit-Saver, rruga "Taulantia"	P452ACV	12,616,223	-	9,000,000	9,000,000		
04520	05 TR	2129001	Sistemim i segmenteve rrugore Taqi Loshe dhe Riza Kaposhi	P452ACT	8,224,693	8,224,693	-	8,224,693		
04520	01 TR	2129001	Urbanizimi i bllokut te banimit ne lagjen Xhevdet Nepravishta, rruga Ahmet Shabani	P452ACY	18,953,508	4,000,000	14,953,508	18,953,508		
04520	05	2129001	Sistemime rrugore ne lagjen 18 Tetori ndermjet rrugeve Hysni Gorovelli dhe Athina Dhimitri	P452ACZ	31,929,696	20,550,527	11,379,169	31,929,696		
04520	05 TR	2129001	Urbanizimi i Qendres Karbunare	P452ADA	19,175,613	13,000,000	6,175,613	19,175,613		
04520	01	2129001	Permiresim i infrastruktures ne zona informale ne proces legalizimi ne lagjen Gafurr Muco	P452ACM	32,943,391			-	16,471,696	16,471,696
04240	05 TR	2129001	Rehabilitim i shkarkuesit ne rezervuarin Kasharaj	P424AAT	32,964,687	6,592,937	-	6,592,937		
09230	01 TR	2129001	Rindertimi i shkolles se mesme te bashkuar "Zyber Sharka"	P923AAT	56,699,683	16,048,254		16,048,254		
04760	05 TR	2129001	Mobilim ne Rikonstruksion I katit nentoke te Muzeut dhe kthim ne qender te teknologjise dhe informacionit	P476AAF	6,242,684	1,382,124		1,382,124		
06260	01TR	2129001	"Rikonstruksion i njësisë Administrative Krutje	P626AGM	23,332,010	23,332,010		23,332,010		
04520	01TR	2129001	1. Sistemim, asfaltim i rruges se Trashallareve ne Ngurrez te Vogel;	1. P452AHQ	8,051,702	8,051,702		8,051,702		

04520	01TR	2129001	2. Nderhyrje ne infrastrukturen e segmenteve rrugore ne Cukas te Ri;	2. P452AHP	8,738,881	8,738,881		8,738,881		
04520	01TR	2129001	3.Sistemim, asfaltim i rruges se Hoxhallareve ne Ardenice	3. P452AHR	5,470,109	5,470,109		5,470,109		
03140	01 TR	2129001	Blerje automjet 6+1 per nevojat e Policise Bashkiake	V314AAB	1,200,000	1,200,000		1,200,000		
04520	05	2129001	Ndertim i qendres shendetesore Fiershegan		8,143,702		8,143,702	8,143,702		
04520	05	2129001	Urbanizim i Bllokut te banimit ne Lagjen "18 Tetori": 1-Rruga "Myfit Vokopola" 2-Rruga "Altin Mino", 3-"Degezimi djathtas i segmentit rrugor "Altin Mino", 4-"Rruga "Gani Dranga"+Supervizimi ,Kolaudimi		38,381,551		11,514,465	11,514,465	13,433,543	13,433,543
04520	05	2129001	Nderhyrje ne infrastrukturen e rruges "Iljaz Ahmeti"+Supervizimi ,Kolaudimi		46,396,670		18,558,668	18,558,668	13,919,001	13,919,001
04520	05	2129001	Sistemim - Asfaltim i rruges "Golem i Madh"-"Golem i vogel"+Supervizimi ,Kolaudimi		85,733,181		25,719,954	25,719,954	30,006,613	30,006,613
04520	01	2129001	Rikonstruksion u godines Ish Posta Kolonje+Supervizimi ,Kolaudimi		18,197,871		5,459,361	5,459,361	6,369,255	6,369,255
3,280	01	2129001	Ndertim i godines se re te MZSH+Supervizimi ,Kolaudimi		34,112,730		10,233,819	10,233,819	11,939,456	11,939,456
04520	01 TR	2129001	Ndertim i varrezave te reja, Lagja Çlirimi, Faza 2+Supervizimi ,Kolaudimi		71,050,000		21,315,000	21,315,000	24,867,500	24,867,500
04520	01	2129001	Sistemim- Asfaltim i rrugeve: 1"Kozma Kondakciu" 2-"Demir Quka" dhe Segmenti i Rruges Abedin Llapi+Supervizimi ,Kolaudimi		37,128,993		11,138,698	11,138,698	12,995,148	12,995,148
04520	01	2129001	Urbanizim i Bllokut te banimit ne Lagjen "Gafurr Muco": 1-Rruga "Myzeqeja" 2-Rruga "Topalltia", 3-"Hamit Xheka "+Supervizimi ,Kolaudimi		45,804,000		13,741,200	13,741,200	16,031,400	16,031,400
05100	05	2129010	Blerje mjet (Blerje kamioncin mbi 3.5 TON,.Blerje vinc Ashensor per krasitje)		5,500,000		5,500,000	5,500,000	10,000,000	10,000,000
04240	01 SPC	2129010	Investime Bordi kullimit (Blerje mjetesh(Blerje kamioni 2-Aaks,Blerje Dung Fungu 3.5tone me kater goma vetshkarkues))	P424AAB	10,000,000		10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000
09120	01	2129012	Rikonstruksione ne kopshte	P912AAG	8,000,000		8,000,000	8,000,000	112,843,072	17,843,072
09120	01	2129012	Blerje paisje & Investime te tjera	P912AAF	1,000,000		2,000,000	2,000,000	2,000,000	4,797,198
9240	01 SPC	2129012	Investime te tjera Q.Arsimi	P912AAH	1,000,000		1,000,000	1,000,000	3,000,000	3,000,000
08220	01	2129011	Blerje pajisje te tjera Qendres Kulturore	P822AAB	3,000,000		3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
			Shuma e investimeve			171,742,286	261,232,377	432,974,662	437,315,694	437,315,695

Metodologjia e Re

Bashkia Lushnje është pjesë e metodologjisë së re viti i tretë, dhe ka parashikuar zbatimin e buxhetit në pesë programe buxhetore si dhe programi i rezervës dhe kontigjencës, i cili është hartuar më vete. Buxheti total i Bashkisë Lushnje menaxhohet sipas 5 programeve të shpenzimeve të cilat lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Programet buxhetore janë sipas standerdeve të përcaktuara në Udhëzimin 23/2018, të ndryshuar, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimin 6/2023 për Bashkitë pilot. Përgatitja e PBA-së 2026-2028 si edhe Buxheti 2026 janë përgatitur sipas metodologjisë së re. Lista e programeve të Bashkisë, sipas metodologjisë së re konsiston në:

1) AA129 Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse, në të cilin kemi përfshirë funksionet e

a)Planifimimi, Menaxhimi dhe Administrimi, b) Shërbimet e Policisë Vendore, c) Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi, d) Mbrojtja dhe Emergjenca Civile, e) Transporti Publik. f) Subjekte Tregtare të Inspektuara, g) Shërbim i stafit te zhvillimit të Turizmit.

2) AB129 Shërbimet Publike Komunitare, në të cilin kemi përfshirë funksionet: a) Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit, b) Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave, c) Rrjeti rrugor, d) Menaxhimi i mbetjeve, e) Sherbimet publike vendore.

3) AC129 Arsimi, në të cilin kemi përfshirë funksionet: a) Arsimi baze, parashkollor dhe çerdhe, b) Arsimi i mesëm i përgjithshëm, Arsimi profesional, c) Kujdesi social për PAK,

4) AD129 Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe Social, në të cilin kemi përfshirë funksionet: a) Shërbime bujqësore, inspektime, siguria ushqimore dhe mbrojtja konsumatore, b) Sigurimi shoqëror (të moshuarit) dhe c) Strehimi social.

5) AE129 Art, Kulturë, Sport dhe Turizëm, në të cilin kemi përfshirë funksionet: a) Sport dhe argëtim, b) Sport dhe argëtim-Futbolli, dhe c) Art dhe Kulturë.

6) AF129 Rezerva dhe Kontigjenca.

Tabela përmbledhese sipas programeve dhe llojit të shpenzimeve.

Emërtimi ,kodi progrmit			VITI 2026 (SHPENZIMET)			
			SHUMA	*Paga & Sigurime*	*Korente të Tjera*	*Kapitale*
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	*AA129*	534,320,647	384,657,000	101,786,443	47,877,204
2	Shërbimet Publike Komunitare	*AB129*	891,308,499	255,740,249	306,754,776	328,813,474
3	Arsimi	*AC129*	491,949,844	390,111,648	50,960,000	50,878,196
4	Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe Social	*AD129*	56,576,172	38,193,454	18,382,718	0
5	Art, Kulturë, Sport & Turizëm	*AE129*	145,642,173	71,976,384	68,260,000	5,405,789
6	Rezerva dhe Kontigjenca	*AF129*	13,000,000	0	13,000,000	0
		Totali	**2,132,797,335**	**1,140,678,735**	**559,143,937**	**432,974,662**

Përshkrimi i Disa nga Funksioneve Buxhetore

1. Planifikimi, Menaxhimi &Administrimi

Përshkrimi i Funksionit	Ky funksion parashikon menaxhimin financiar të

	Bashkisë Lushnje dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore.
Qëllimi i këtij funksioni	Politika e këtij funksioni konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë Lushnje, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.
Fokusi	– Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë së Lushnjes dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj, – Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin ; – Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike të qytetit, – Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me trasparencë, eficencë ekonomike dhe implementimin e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm, – Krijimi i një institucioni efiçient, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve, – Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë. – Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme,

	rritja e numrit të taksapaguesëve, dhe reduktimin e elementeve të evazionit, – Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut, – Fushata informative dhe sensibilizuese për ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore ndaj Bashkisë, – Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së internetit të Bashkisë së Lushnjes për pasqyrimin me transparencë të punës së Bashkisë Lushnje, – Forcimin e kontrollit mbi territorin urban në fushën e ndërtimeve, të veterinarisë, të kontrollit ushqimor dhe atij të qendrave e shërbimeve komunitare.
Njësitë shpenzuese	Bashkia Lushnje

2. Shërbimet E Policisë Vendore.

Përshkrimi i Funksionit	Ky funksion mbulon shërbimet policore që janë të nevojshme për ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe për parandalimin e konflikteve dhe bashkëpunim me Policinë e Shtetit për raste të veçanta.
Qëllimi i këtij funksioni	Politika e këtij funksioni synon sigurimin e mbrojtjes, të qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë. Është ndihmesë në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që krijohen gjatë ushtrimit të funksioneve të Bashkisë dhe zbatimit të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse sipas fushës, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror.
Fokusi	- Ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brënda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë

	në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; - Ekzekutimin dhe zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit të Bashkisë - Trajnimin e herë pas hershëm të punonjësve të tij.
Njësitë shpenzuese	- Bashkia Lushnje

3.Mbrojtja Nga Zjarri, Emergjenca Dhe Mbrojtja Civile

Përshkrimi i Funksionit	Shërbimit të Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimit parashikon ndërhyrjet në raste emergjente në qytetin e Lushnjes, njësitë dhe më gjerë, në funksion të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe marrjen e masave për parandalimin e zjarrit.
Qëllimi i këtij funksioni	Politika e këtij funksioni synon marrjen e masave për parandalimin e zjarrit dhe në rastet e ndodhjes, shpëtimin e sa më shumë jetëve, banesave dhe të mirave materiale.
Fokusi	- Ndërhyrja në kohë rekord në raste të emergjencave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin e sa më shumë jetëve, objekteve, dhe vlerave materiale. - Mbajtjen në gadishmeri të mjeteve dhe personelit për ndërhyrje të menjëhershme. - Marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e zjarreve. - Trajnimin e herëpashershëm të punonjësve të tij, duke hartuar programe trajnuese për parandalimin dhe mbrojtjen kundër zjarrit. - Mbajtjen në gatishmëri të mjeteve zjarrfikëse. - Ardhja në ndihmë të qytetarëve edhe me fondet e Bashkise për mbulimin e dëmeve të krijuara nga fatkeqësitë dhe epidemitë.
Njësitë shpenzuese	- Bashkia Lushnje

5. Ujitja Dhe Kullimi

Përshkrimi i Funksionit	Funksioni i Ujitjes dhe Kullimit synon mbajtjen në gatishmeri të plotë të kanaleve kulluese dhe ujitëse si dhe të veprave te artit në Bashkinë e Lushnjes,si dhe administrimin,shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e bashkisë.
Qëllimi i këtij funksioni	Politika e këtij funksioni synon nxitjen, zhvillimin dhe shtimin e kapaciteteve në drejtim të mirëmbajtjes së veprave ujitese e kulluese me qëllim eleminimin e përmbytjeve dhe krijimin e kushteve të domosdoshme në ndihmë të banorëve që merren me bujqësi, etj.
Fokusi	- Rehabilitimi i skemave ujitëse dhe kulluese. - Vënien në funksionim dhe mirëmbajtjen e rezervuarëve të ujitjes. - Shtimin e sipërfaqeve të vaditshme. - Sigurimin e sa më shumë sipërfaqeve të kulluara. - Mbajtjen në gatishmëri të mjeteve për kryerjen e punimeve të nevojshme.
Njësitë shpenzuese	- Ndërmarrja e Pasurisë Publike

6. Menaxhimi i Pyjeve Dhe Kullotave

Përshkrimi i Funksionit	Funksioni i Administrimit të pyjeve parashikon organizimin e punës për ruajtjen dhe mbrojtjen e këtij shërbimi në gjithë rrethin e Lushnjës, pjesë e juridiksionit të Bashkisë.
Qëllimi i këtij funksioni	Politika e këtij funksioni synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës qytetare në drejtim të mbrojtjes dhe shtimit të sipërfaqeve pyjore e kullosore.
Fokusi	- Mbështetja financiare për ruajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore. - Mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve nga prerjet dhe dëmtimet - Ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen dhe

	shtimin e këtyre pasurive.
Njësitë shpenzuese	- Ndërmarrja e Pasurisë Publike.

7. Rrjeti Rrugor

Përshkrimi i Funksionit	Parashikon ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.
Qëllimi i këtij funksioni	Synojmë arritjen e standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike dhe në ofrimin e tyre me cilësi në të gjithë qytetin, për të siguruar një qytet të mirëshërbyer në infrastrukturë publike cilësore.
